




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: N.N.P. “ Wenda “ –Vushtrri, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën **23.07.2021**, merr këtë:

V E N D I M

- 1. Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e pasuksesshëm, të subjektit në procedurë: N.N.P. “ Wenda “ – Vushtrri , në **procedurën e prokurimit me titull: Renovimi i shkollave, Nr.i prokurimit: VU644 – 21 – 2822 – 5-2-1 e Nr. i brendshëm: 644-21-042-521.**
- 2. Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. **13.07.2021**

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që ta rekomandoi për dhënie të kontratës : **Lot. 1 O.E.: “ MAK Building “sh.p.k. me seli në Vushtrri dhe Lot. 2 O.E. : “ Limit Project “sh.p.k. me seli në Drenas, ndërsa, O.E.: NNP “ Wenda “ (në tekstin e mëtejme Ankuesin) për shkak të mosplotësimit të kërkesave të saktësuara në Seksionin II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD) Kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe / ose profesionale pika 2, e ka eliminuar nga aktiviteti i mëtejme duke e renditur në mesin e tenderuesve të papërgjegjshëm , bazuar në procedurën e zbatuar.**

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e eliminuar për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. **13.07.2021**, bazuar në dispozitat e nenit 43 të Rregullores mbi Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se, duke vendosur si në Vendimin e dt. 13.07.2021, A.K. ka shkelur dispozitat e LPP-së , konkretisht: nenin 1 – Qëllimi, nenin 2 paragrafi 1 – Fushëveprimi, nenin 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, nenin 7 – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, nenin 60 – Kriteret për Dhënie të Kontratës, nenin 72 – dokumentacioni dhe informacioni shtesë , si dhe nenin 39,40 dhe 41 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, (në tekstin e mëtejme ROUPP)

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë , për arsye se:

- Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, neni 7 ka pasur për qëllim trajtimin e barabartë, pa diskriminuar asnjë prej O.E. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, Neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dh krahasimi i tenderëve) lidhur me nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 (**tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët**) ka pasur për qëllim, që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimit dhe vlerësimi të tenderëve, të vendosë për dhënie të kontratës O.E. me **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 13.07.2021 është marrë

bazuar në kushtet , rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së, vendimi, sikurse ka vlerësuar A.K., është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i pandikuar, që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe qenësore të dispozitave të LPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent, duke përfshirë këtu edhe të drejtën Ankuesit për të realizuar qasjen në dokumente të tenderit, konform nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës : **Lot. 1 OE.: “ MAK Building “sh.p.k. me seli në Vushtrri dhe Lot. 2 O.E. : “ Limit Project “sh.p.k. me seli në Drenas** është marrë në mes tjerash edhe në zbatimin e nenit 59 të LPP-së, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përmbushë kërkesat administrative, profesionale dhe minimalisht ato teknike dhe / ose profesionale të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.
3. Më tej, sa i përket pretendimeve të Ankuesit, duke përdorur edhe fjalë jo etike dhe aq më pakë profesionale , si , citat “ ka huqë në vlerësim të aktivitetit “ ose “ duke na vënë në lajthitje “ pa dashur të polemizojmë me këto pretendime tendencioze dhe aspak të bazuara, si A.K., gjatë procesit të ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve, edhe një herë kemi rivlerësuar dhe ri konstatuar se procesi i vlerësimit është zbatuar në përpikmëri me dispozitat e LPP-së. Fakti se Ankuesit, më dt. 06.07.2021 bazuar në nenin 72 të LPP-së, përmes Letrës standarde i është kërkuar sqarim shtesë tregon se si A.K. kemi pasur qasje profesionale dhe plotësisht të bazuar në dispozitat e nenit 72 të LPP-së. Dëshmitë e dorëzuara si përgjigje e Ankuesit, nga A.K. janë pranuar dhe marrë për bazë gjatë procesit të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Po ashtu mbi bazën e vlerësimit të dëshmimeve të dorëzuara sikurse janë: Lista e projekteve të realizuara nga O.E. “ H & B “sh.p.k. dhe Referenca kolektive e lëshuar për znj. Rexhepi, nga po i njëjti O.E., A.K. ka marrë vendimin sipas të cilit ka konstatuar se Ankuesi respektivisht znj. Emina Rexhepi, e cila me vendim të Ankuesit, është emëruar në detyrën e Menaxherit të Kontratës/projektit, nuk i ka përmbushur Kërkesat e saktësuar në Seksionin II. Fleta e Të Dhënave të Tenderit (FTD) të Dosjes së Tenderit, Kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe / ose profesional, neni 9.1 lidhur me 9.2, pika 2 Kërkesa : “ Një (1) inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë apo master, 7 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi Arkitekturë), me eksperiencë profesionale, të ketë të realizuar minimum 3 (tre) projekte në tre vitet e fundit, në detyrë të menaxherit të projektit “ dhe Dëshmia dokumentuese : “ Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe e vulosur, listës duhet të i bashkëngjiten këto dëshmi a) CV-ja e nënshkruar nga inxhinieri , Diploma, Kontrata apo Parakontrata e punës e nënshkruar dhe e vulosur nga Punëdhënësi “ që nënkupton se për Menaxherin e Projektit – Kontratës znj. Emina Rexhepi nuk ka dorëzuar min. tri referenca valide përmes së cilave dëshmohet se znj. Rexhepi ka menaxhuar dhe përfunduar me sukses tri projekte, në periudhën e shkuar tre vjeçare, ashtu sikurse është saktësuar në Seksionin II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD) – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale pika 2 nënpika (a). Nga Referenca e lëshuar prej O.E. “ H & B “ për znj. Rexhiq, për projektet: Renovimi i objektit në Blinaj, i përfunduar në vitin 2015, Ndërtimi i Qendrës së Arsimit në Livagje, i përfunduar në vitin 2014, dhe projekti Riparimi i fasadës dhe ndërrimi i dritareve të kulmit në shkollën “ Vuk Karagjij “ i përfunduar në vitin 2017 pakontestueshëm është vërtetuar se nuk janë referenca valide sepse nuk përmbushin periudhën trevjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, ashtu sikurse është saktësuar – kërkuar në Seksionin II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD) – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale pika 2 nënpika (a) kurse projekti “ Renovimi i shkollave dhe blerja e pajisjeve – Komuna Obiliq “ nuk është përfshirë në Listën e projekteve të të përfunduara nga O.E. : H & B , rrjedhimisht rezulton se ky projekt nuk është realizuar nga O.E. “ H & B “ dhe po ashtu rrjedhimisht nuk është menaxhuar dhe / ose mbikëqyrë nga znj. Rexhiq, andaj si e tillë referenca e dorëzuar për këtë projekt ka qenë fiktive, jo e dëshmuar, jo e rregullt, rrjedhimisht jo e pranuar prej A.K. Po ashtu edhe CV-ja e dorëzuar nuk është dorëzuar e nënshkruar nga Inxhinjeri-ja, ashtu sikurse është saktësuar në Seksionin II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD) – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale pika 2 – Dëshmitë e kërkuara. Andaj A.K. e ka vlerësuar tenderin e Ankuesit si të papërgjegjshëm sepse tenderi i Ankuesit nuk ishte në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.
4. Sa i përket dorëzimit, në Kërkesën për Rishqyrtim, të refrencave tjera të cilat nuk kanë qenë të dorëzuara as në dosjen e tenderit dhe as të bashkangjitura në Kërkesën për sqarim tenderi të dt.

06.07.2021, A.K. konstaton se dorëzimi i dëshmimeve shtesë në këtë fazë respektivisht pranimi i dokumenteve të tilla do të ishte shkelje e dispozitave të nenit 59 pika 4 të LPP-së sepse do të përbënte devijim që do të shkaktonte ndryshime materiale ose devijim të nga kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, andaj si të tilla nuk janë pranuar sepse **Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i dokumentacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mundë të verifikohet në mënyrë objektive**, që në rastin konkret është Referenca e lëshuar nga O.E. “ H & B “ me seli në Prishtinë dhe projektet e emërtuara në Referencën në fjalë që ndërlihen dhe me CV-in e znj. Rexhepi. Po ashtu, pranimi eventual i dokumenteve shtesë jashtë afatit të saktësuar në Kërkesën e A.K. do të nënkuptonte mospërputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit në fjalë dhe po ashtu do të cenonte nenin 10 të LPP-së, promovimin e transparencës. Mbi këtë bazë, A.K. konstaton se Ankuesi, në Kërkesën për rishqyrtim, me asnjë element nuk ka argumentuar shkeljet prej A.K. të dispozitave ligjore të LPP-së dhe / ose RUOPP, andaj pretendimet e tilla të Ankuesit, A.K. i ka hedhur poshtë si të paargumentuara dhe për rrjedhojë si të pa qëndrueshme. Ndërsa, sa i përket pretendimit të Ankuesit se O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës kanë çmime më të larta se Ankuesi, A.K. vlerëson se vetëm O.E. të cilët kanë përbushur Kërkesat Administrative, Profesionale, Ekonomike Financiare dhe ato Teknike /Profesionale të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë mundë të radhiten në mesin e O.E. të përgjegjshëm dhe mundë të propozohen për rekomandim për dhënie të kontratës, gjë që me Ankuesin nuk është rasti.

5. Ndërsa sa i përket pretendimit tjetër për mbrojtjen e parimit “ VLERA PËR PARANË “ , A.K. vlerëson se fillimisht duhen respektuar dispozitat ligjore lidhur me procesin e Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahasimit të tenderëve duke marrë për bazë dhe transparencën, Trajtimin e barabartë të O.E. dhe jo-diskriminim në mes të O.E. duke përfunduar me zbatimin e parimit të “ vlera për paranë “ i cili në fakt është parim shumë i rëndësishëm për buxhetin e A.K. dhe të cilin sigurisht se A.K. e ka pasur në konsideratë.
6. Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit janë të pabazuara, të pasakta dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Përfundimisht, A.K. vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit si ai i dt. 13.07.2021 për të përzgjedhur për rekomandim me dhënie të kontratës të O.E.: Lot. 1 O.E.: “ MAK Building “sh.p.k. me seli në Vushtrri dhe Lot. 2 O.E. : “ Limit Project “sh.p.k. me seli në Drenas, nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, me theks të veçantë neni 1 – Qëllimi, nenin 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti, neni 7 – Barazia në trajtim/ Jo - diskriminimi sepse është rekomanduar O.E. me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët ndërsa me asnjë provë nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo-barabar apo diskriminuese, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 51 – Njoftimi i kritereve të dhënies së kontratës dhe neni 59 parag.4 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Nga sa u tha me lartë, e në pajtim me nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 të Rregullave për paraqitje të kërkesë për rishqyrtim, A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
K.R. nr. 042/2021 - datë 23/07/2021

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkiviti (1 kopje)

Drejtoria për Prokurim Publik


Amir Haradinaj -ZPP